



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:227173

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05624086

Ac.nr.2818/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.... D... nga Fshati Magure, Komuna e Lipjanit, të ilin me autoizime përfaqëson avokati S.... K..... nga Lipjani, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës Prishtinë të cilën me autorizim e përfaqëson D..... B....., në çështjen juridike për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1445/11, të datës 24.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurës Këshilli Gjyqësorë i Kosovës me seli në Prishtinë në rrugën “Luan Haradinaj”, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1445/11 i datës 24.12.2020 në pikën I të dispozitivit të tij, që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit jo material dhe çështja gjykohet si në vijim: **APROVOHET PJESËRISHT** si e themeltë kërkesëpadia e paditësit S..... D..... nga Fshati Magure, Komuna e Lipjanit dhe **DETYROHET** e paditura Këshilli Gjyqësorë i Kosovës që në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të privimit të paarsyeshëm nga liria për 60 ditë, t’ia paguaj paditësit shumën prej **3,000.00 Euro**, në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të cënimit të autoritetit, ndërit personal, dëmtimit të karrierrës dhe lirisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, nga shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, **REFUZOHET SI E PA BAZUAR**.

II. PIKA II, III dhe IV e dispozitivit të Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1445/11 të datës 24.12.2020, mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.1445/11 të datës 24.12.2020 ka vendosur në këtë mënyrë: **APROVOHET PJESËRISHT** kërkesëpadia e paditësit S.....

D..... nga fshati Magure, Komuna e Lipjanit, ashtu që **DETYROHET** i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të demit jo material, për shkak të cënimit të dinjitetit profesional, integritetit dhe dinjitetit personal, nderit, lirisë dhe të drejtave të njeriut, për shkak të privimit të lirisë në mënyrë të kundërligjshme prej datës 13.11.2008 e deri me datë 12.01.2009 gjithsej 60 ditë, t'ia paguaj shumën e specifikuar si më poshtë: Në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të cënimit të dinjitetit profesional, integritetit dhe dinjitetit personal, nderit, lirisë dhe të drejtave të njeriut, shumën prej6,000.00 Euro. **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën e cekura në pikën – I (a) – të këtij dispozitivi, me kamatë si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, nga dita e marrjes së aktgjykimit datë 24.12.2020 e deri në përmbushje definitive, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën detyrimin e përmbartimit të detyrueshëm. **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumës së aprovuar në pikën - I - të këtij dispozitivi, dhe atë: në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të cënimit të dinjitetit profesional, integritetit dhe dinjitetit personal, nderit, lirisë dhe të drejtave të njeriut, dhe atë shumën prej 104,000.00 Euro, si dhe kërkesa për kamatë në lartësinë minimale prej 3.5% vjetore duke filluar nga data 13.05.2011, kur është paraqitur kërkesa për procedurë jashtëgjyqësore e deri në pagesën definitive, si dhe kërkesa për kompensimin e shpenzimeve përtej shumës së dhënë në pikën - IV - të këtij dispozitivi, si e pabazuar. **DETYROHET** e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës që paditësit t'ia paguaj shumën prej 694.00 Euro, në emër të shpenzimeve gjyqësore, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Kundër këtij Aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka parashtruar ankesë, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në të njëjtën.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padi dhe kërkesëpadi ka kërkuar që të detyrohen të paditurat që në emër të demit jo material për shkak të privimit të kundërligjshëm nga liria për 60 ditë, t'ia paguajnë paditësit shumën e tërësishme prej 110,000.00 euro.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka administruar provat si në arsyetimin e atakuar dhe pas vlerësimit të tyre ka vendosur si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të Aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, ka theksuar se nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para

gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se paditësi kishte qenë i privuar nga liria duke qenë i mbajtur në masën e paraburgimit për 39 ditë si dhe në arrest shtëpiak për 21 ditë. Së këndejmi lidhur me këtë fakt, ndonëse gjykata ka administruar prova, nuk do të lëshohet gjerësisht në vlerësimin tyre. Nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse që paditësi është familjar, baba i tre fëmijëve. Gjithashtu, nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse se paditësi është doktor i mjekësisë – specialist nga Anesteziologjia me Mjekim Intensiv. Për këtë arsye, megjithëse gjykata administroi provat që dëshmojnë këtë, nuk do të lëshohet në elaborimin e të njëjtave. Gjithashtu, nga provat e administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa-kontestueshëm se paditësi ishte akuzuar nga ish Prokuroria Publike e Qarkut për kryerjen e veprave penale “Krimet të organizuar”, përcaktuar me nenin 274 të KPK-së, “Mashtrim” përcaktuar në nenin 261 të KPK-së si dhe veprën penale “Trafikim me organe”, të përcaktuar me nenin 139, të KPK-së. Nuk ishte kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse as fakti se paditësin kur e kanë arrestuar e kanë marrë të prangosur nga vendi i punës në Spitalin Turk IVF Center, ku është ekspozuar me kamera në media dhe në publik. Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte nëse paditësi ka të drejtë në lartësinë e shumave të kompensimit, kurse për këtë, palët kishin qëndrime tërësisht të kundërta. Meqenëse paditësi ka qenë i privuar nga liria për 60 ditë (fakt i pa kontestuar nga palët ndërgjyqëse), i njëjti i ishte drejtuar me kërkesë të të paditurit, përkatësisht Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjegjësisht Komisionit për Kompensim Dëmi Personave të Dënuar pa Arsye dhe të Privuar nga Liria pa Bazë, për kompensim dëmi jo-material. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjegjësisht Komisioni për Kompensim Dëmi Personave të Dënuar pa Arsye dhe të Privuar nga Liria pa Bazë, me datën 17.05.2011 i kishte ofruar paditësit marrëveshje jashtë-gjyqësore (mbi bazën e kërkesës së të njëjtit) dhe atë për qëndrimin në arrest shtëpiak pa arsye në kohëzgjatje prej 21 ditësh, shumën e përgjithshme prej 210 Euro ndërsa me datën 18.05.2011, i kishte ofruar paditësit marrëveshje jashtë-gjyqësore (mbi bazën e kërkesës së të njëjtit) dhe atë për qëndrimin në paraburgim në kohëzgjatje prej 39 ditësh, shumën e përgjithshme prej 638 Euro. Nga provat e administruara nga gjykata dhe thëniet e palëve në procedurë rezulton se paditësi nuk e ka pranuar ofertën e të paditurës dhe i është drejtuar gjykatës me padi për kompensim të dëmi jo-material. Gjykata për të vërtetuar intensitetin e dhimbjeve shpirtërore, shqetësimeve dhe frikës që mund të ketë pësuar paditësi, si pasojë e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak, ka nxjerrë provën me ekspertizë nga lëmi i psikiatrisë, të punuar nga N..... M....., psikiatër. E njëjta në mendimin e saj ka paraqitur se paditësi si pasojë e qëndrimit në paraburgim gjatë periudhës nga data 13.11.2008 deri me datën 22.12.2008 ka përjetuar vuajtje dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë, sidomos në rastin kur e kanë arrestuar dhe e kanë marrë të prangosur nga vendi i punës në Spitalin Turk IVF Center, ekspozimi me kamera në media dhe në publik, që paraqet dëmtim të rëndë të integritetit, personalitetit dhe imazhit personal e moralit profesional, e që më tej në paraburgim janë manifestuar me vështirësi të dukshme të adaptimit në kushte penale dhe ballafaqimin me akuzën e rëndë që i është vënë në barrë, ndjenja e frikës dhe stresit intensiv, brengës, pasigurisë dhe ankthit për të ardhmen e tij, shoqëruar shpesh me rënie disponimi dhe vullneti, i kishte lënë fëmijët shumë të mërzitur, nënën e sëmurë dhe obligime tjera nga të cilat ish-in privuar familjarët e tij. Gjatë kohës sa ka qenë në arrest shtëpiak ka manifestuar dhimbje dhe vuajtje shpirtërore që kanë qenë të intensitetit të mesëm e që kanë zgjatur rreth tre muaj, për shkak se ndër të tjera është ndjerë i stigmatizuar dhe i turpëruar nga akuza, ndjenja e stigmës për akuzën që i është bërë e ka shoqëruar tërë kohën, duke e bërë të ndihet keq, me ankth dhe i dëshpëruar. Ka shtuar se dhimbjet

shpirtërore të paditësit kanë vazhduar më tej por me një intensitet të ulët e cila ka vazhduar deri në ndërprerjen e plotë të procedurës dhe kur janë pushuar hetimet me datën 23.09.2010, shoqëruar me rënie persistente të disponimit dhe vullnetit, humbje të shpresës për të ardhmen dhe mendime pesimiste, frikë të vazhdueshme se do të dënohet pa faj, stres, demoralizim, dëshpërim dhe mungesë të motivit për jetë. Ka shtuar se paditësi sot e asaj dite ka pasur ende herë pas here dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët por që janë manifestuar vetëm në raste kur është biseduar për rrethanat dhe ngjarjen, aktualisht reflekton me një personalitet të ndjeshëm në aspekt emocional dhe që kërkon angazhim shtesë të mekanizmave mbrojtës psikologjik në situatë stresi dhe mbingarkese psikike. Gjykata ekspertizën mjekësore të psikiatrisë, e ka pranuar në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna të detajuara lidhur me vërtetimin e fakteve në këtë çështje kontestimore. Për më tepër, ekspertja e psikiatrisë ekspertizën e vet e ka sqaruar edhe në shqyrtimin kryesor, sqarime të cilave gjykata ua falë besimin e plotë sepse ishin në përputhje të plotë me faktet e rastit. Sa i përket qëndrimit të të paditurës se ekspertizës nuk duhet t'i falet besimi për shkak se ka kaluar kohë e gjatë prej kur ka ndodhur rasti dhe nuk mund të jepet një mendim i drejtë, gjykata pranoi sqarimin e ekspertes së psikiatrisë sa i përket kësaj çështje e cila e sqaroi me argumente profesionale se ekzaminimi i paditësit ka qenë i mundur dhe konstatimi i saj është i bazuar. **Ligji i zbatueshëm** Neni 538 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, shprehimisht përcakton se “[e] drejta në kompensim dëmi i takon Personit i cili ka qenë në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar. Gjithashtu, në rastin konkret aplikohet dispozita e nenit 154 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare nr.29/78 (LMD) sipas se cilës dispozitë është përcaktuar se “[k]ush i shkakton dëm tjetrit është i detyruar t’ia kompensoj për deri sa te mos provoj se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në lidhje me këtë, gjykata konsideron se e paditura në rastin konkret duhet ta kompensoj dëmin e shkaktuar paditësit me paraburgim dhe privim nga liria në mënyrë të pa drejtë. Neni 200, par. 1, i LMD-së, sipas të cilit për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material. Kurse në paragrafin 2 të këtij neni parashihet se “[m]e rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo-material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.” **Shuma e gjykuar** Gjykata vlerëson se tek ky rast përmbushen elementet e lidhjes shkakore që paraqet raportin e ndërsjellët ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Çdo ngjarje që është kusht për dëmin, d.m.th., pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron të paditurin të shpërblej dëmin. Gjykata arriti në përfundim se privimi i kundërligjshëm i lirisë së paditësit për 60 ditë, ka ndodhur pa fajin e paditësit kurse atij i është shkaktuar dëm, e që në rastin konkret konsistojnë

në dëmin jo-material mbi frikën e përjetuar, degradim personalitetit, dinjitetit, cenim ndaj nderit, të drejtave dhe lirive themelore njerëzore, të cilat kanë ndikuar me pasoja si në jetën, personale, profesionale, miqësore dhe shume relacione tjera njerëzore. Kompensimin e dëmit jo-material (moral), për shkak të dhimbjeve shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë, si dhe frikës së përjetuar, gjykata u mbështet në mendimin profesional të dhënë nga eksperti psikiatër, i cili mendim sipas vlerësimit të gjykatës në mënyrë profesionale ka konstatuar se paditësi gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak, ka përjetuar mërzi, ankth, ka qenë shumë i preokupuar rreth fatit të tij, i shqetësuar, zhgënjyer, për shkak të veprës penale për të cilën është akuzuar. Paditësi gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensiteteve të cilat janë paraqitur tek gjendja faktike e vërtetuar. Gjykata duke analizuar të gjitha provat dhe rrethanat e rastit në lidhje me vuajtjet e përjetuara nga paditësi si pasojë e akuzave të pa bazuara ndaj tij, pastaj edhe gjendjen ekonomike dhe zhvillimore në vend, vlerëson se shuma e gjykuar nuk është shumë me të cilën arrihet shpërblimi absolut i dëmit, por paraqet një lloj satisfaksioni për të mirën e dëmtuar. Nisur nga kjo bazë, gjykata nuk i ka marrë për bazë Kriteret për kompensimin e dëmit për personat e dënuar pa arsye dhe personave të privuar pa bazë nga liria, të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 04/2015. Gjykata vlerëson se shumata e gjykuara për paditësin paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar nga ai gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak, dhimbjet shpirtërore të përjetuara nga paditësi, e të cilat gjykata i caktoi sipas bindjes së lirë konform nenit 323 të LPK-së po ashtu dhe dispozitave të LMD-së neni 200. Gjithashtu, me rastin e vendosjes, gjykata i pati si orientim kriteret dhe masat e vëna nga praktika gjyqësore lidhur me lartësinë e dëmeve jo materiale, posaçërisht lidhur me kompensimet e kësaj natyre. Po ashtu me rastin e vendosjes për vlerën e kompensimit ka marrë parasysh edhe rrethanat tjera që janë ndikuar, siç janë kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak, natyra e veprës për të cilën ka qenë akuzuar, profesionin e paditësit, moshën e paditësit dhe rrethanat familjare të tij. Gjykata gjithashtu me rastin e vendosjes pati parasysh edhe faktin e burgosjes së tij në sy të opinionit publik, para kamerave, (fakt i pa-kontestuar nga pala e paditur). Në vlerësimin e gjykatës, kjo ka pasur ndikim në cenimin e nderit dhe prestigjit të paditësit, duke pasur parasysh pozitën që ka mbajtur paditësi, cenim i cili pati ndikim të veçantë në vendosjen e shumave si në dispozitiv. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin e dhënë V. dhe B. kundër Ruisë (2018), lidhur me kompensimin e personave të dënuar pa arsye, ka shprehur qëndrim se detyra e vlerësimit të dëmit që duhet dhënë personit si kompensim është e vështirë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast kur janë në shprehje të drejtat personale, si dhe vuajtja, çoftë fizike apo mendore, është objekt i kërkesës për kompensim. Po ashtu në këtë vendim është thënë se nuk ka ndonjë standard me të cilën dhimbjet shpirtërore, shqetësimi psikologjik dhe ankthi mund të maten në një kundërvlerë të saktësisht të matshme të parave. Më tej Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përmes këtij vendimi ka thënë se vlerësimi nga ana e gjykatave i shumave të matshme të kompensimit, duhet të bëhet duke u bazuar në kriteret të qëndrueshme të cilat duhet të marrin parasysh standardin e jetës të vendit. Sido që të jetë, Gjykata Evropiane ka theksuar se nuk mund të lejohet një shumë tejet e ulët e kompensimit, e cila do të ishte aq e ulët saqë do të minonte frymën e vërtetë të nenit 5.5 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, ngase do të humbiste thelbin e zbatueshmërisë së këtij neni, i cili garanton të drejtën e kompensimit të personave të dënuar apo paraburgosur pa arsye. Të drejtën e kompensimit të personave të mbajtur, arrestuar dhe paraburgosur pa arsye e parasheh edhe

Konventa Evropiane për të Drejtat, e cila ka aplikim direkt në Kosovë, duke u integruar përmes nenit 22 par. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas nenit 5 par. 5 të kësaj Konvente “Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.” Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë përtej shumave të gjykuara, dhe atë: shumën prej 104,000 Euro, ngase vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, e po ashtu duke pasur parasysh edhe shumën e kompensimit që është ndërtuar nga praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi paraqesin kompensim real për këtë lloj të kompensimeve dhe në mënyrë të drejtë për llojin e dëmit të pësuar. **Vendimi për kamatën** Gjykata në lidhje me kamatën ka zbatuar nenin 277, paragrafi 1 të LMD-së, kjo për shkak se kërkesa kryesore kur është shkaktuar ngjarja – raporti juridiko civil është e lidhur me kërkesën aksesore- kamatën, ashtu që dëmi është shkaktuar në kohën kur ka qenë në fuqi ligji i vitit 1978. Për këtë arsye, gjykata refuzoi kërkesën e palës paditëse për kamatë në lartësinë minimale prej 3.5% vjetore duke filluar nga data 13.05.2011, kur është paraqitur kërkesa për procedurë jashtëgjyqësore e deri në pagesën definitive si të pabazuar, për shkak se në rastin konkret duhet të aplikohet dispozita e nenit 277, paragrafit 1 të LMD-së. **Vendimi për shpenzimet e procedurës** Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452, paragrafit 2, të LPK-së. Sa i përket kërkesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditësit që të kompensohen shpenzimet në vlerën e përgjithshme prej 1,681.25 Euro, gjykata nuk e aprovoi pjesën përtej shumës së gjykuar në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shkak se kërkesa për kompensim ishte e bazuar në vlerën që kishte paraqitur në kërkesëpadi paditësi ndërsa vendimi për kompensimin e shpenzimeve, ashtu siç është dhënë në dispozitiv të këtij aktgjykimi është bazuar në vlerën e caktuar nga gjykata, për kompensim nga ana e palës së paditur. Gjithashtu, kërkesa e palës paditëse për kompensim për taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 150 Euro ishte në kundërshtim me dëshminë e pagesës së taksës gjyqësore për padi në këtë çështje kontestimore ku shihet se paditësi ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi në vlerë prej 50 Euro.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, mirëpo gabimisht është zbatuar e drejta materiale, për çka edhe kjo pjesë e dispozitivit të Aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohen, për sa i përket kërkesës për kompensim të dëmit jo material për shkak të qëndrimit të paditësit për 39 ditë në paraburgim dhe 21 ditë në arrest shtëpiak në mënyrë të paarsyeshme.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, mirëpo gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka caktuar shpërblimin e dëmit si në dispozitiv të Aktgjykimit të atakuar, përkatësisht të njejtën e ka caktuar të lartë, në raport me të mirën e cënuar, qëllimin e shpërblimit të dëmit, kritereve të përcaktuara për lartësinë e dëmit të tillë dhe praktikën gjyqësore.

Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë lidhur me bazën e përgjegjësive të të paditurës KGJK për kompensimin e dëmit (bazën juridike të kërkesëpadisë), i pranon në tërësi Gjykata e Apelit, pasi që me të drejtë vërtetimi i kësaj baze bazohet në provat materiale përkatëse, por edhe baza juridike e kërkesëpadisë nuk kontestohet as nga e paditura. Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit, e cila nuk ishte kontestuese nga pala e paditur.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës për aplikimin e gabuar të drejtës materiale për shumën e gjykuar për paditësin në raport me dëmin jo material, për shkak të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, dëmtimit të autoritetit për privim të paarsyeshëm nga liria për 60 ditë, prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e aprovoi ankesën e të paditurës, e ndryshoj aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykoi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, duke vlerësuar se shumata e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material, është e lartë dhe nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Republikës së Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar. Gjykata e Apelit nuk e pranon qëndrimin dhe përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket lartësisë së dëmshpërblimit të cilin në këtë rast ia ka gjykuar paditësit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimin të atakuar, dhe vlerëson se pavarësisht gjendjes së vërtetuar faktike dhe mospërfshirjes së aktgjykimin të atakuar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në këtë pjesë të aktgjykimin, gjykata sa i përket lartësisë së kompensimit për paditësin, ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kur paditësit ia ka caktuar shumën prej 6,000.00 Euro në emër të shpërblimit të dëmit jo material, e cila shumë nuk është në harmoni me praktikën e deritanishme gjyqësore, marrë parasysh raportin juridik dhe periudhën kur ka ndodhur arrestimi dhe privimi i kundërligjshëm i paditësit për 60 ditë.

Gjykata e Apelit vlerëson se tani shumata e gjykuar për paditësin si në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi është adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 par.2 të LMD-së, të zbatuar për këtë rast dhe se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që të dëmtuarit (në këtë rast paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me nenin 200 par.2 të LMD-së përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit dhe me dhimbjet e pësuar, ashtu që ky kompensim të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar për shkak të privimit të paarsyeshëm nga liria për 60 ditë, e në të njëjtën kohë ato të jenë reale

dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit.

Nisur nga fakti se një ditë burgimi është i pa kompensueshëm, gjykata vlerësoi se me shumat e gjykuara me këtë Aktgjykim, për se afërmi arrihet të kompensohet për dhimbjet e përjetuara të paditësit dhe me të arrihet ti ndihmoj paditësit që ti pranojë, si falje e gabimit të bërë nga organet përkatëse. Në nenin 154.1 të LMD-ës parashihet “*Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”, gjykata konsideron se i padituri ne rastin konkret duhet ta korrigjojë dëmin e shkaktuar paditësit me paraburgim të kundërligjshëm, i cili me Aktgjykim të plotfuqishëm është liruar nga akuza.

Gjykata e Apelit gjatë vendimmarrjes me rastin e ndryshimit të aktgjykimit e ka pasur parasysh moshën e paditësit, personalitetin e tij dhe profesionin, ka gëzuar reputacion të mirë në shoqëri, gjithashtu ka marr parasysh edhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tij në paraburgim dhe arrest shtëpiak për 60 ditë, ku gjatë kësaj kohe i njëjti ka përjetuar vuajtje dhe dhimbje shpirtërore që është manifestuar me vështirësi të adaptimit me kushtet penale dhe të ballafaqimit me procedurat gjyqësore, ndjenjën e frikës, ankthit, stresit për shkak të pasigurisë se çka e pret e ardhmja, ndjenjën e thellë të dëmtimit të imazhit dhe dinjitetit personal, moral, profesional dhe prestigjit, të gjitha këto kanë qenë prezentë gjatë periudhës së kufizimit të lirisë, andaj nga këto arsye të lartcekura e ka caktuar shpërblimin e dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit në shumë të përgjithshme prej **3,000.00 euro**, e cila shumë llogaritet se do të përfaqëson një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (në këtë rast paditësi) t’i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para, ku edhe praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg, ka përcaktuar se caktimi i kompensimit për këto kategori duhet të trajtohet si satisfaksion i të dëmtuarve dhe në asnjë mënyrë pasurim i tyre.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjen mbështetje në nenin 154 dhe 200 të LMD-së, por edhe në nenin 5 paragrafi 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, i cili shprehimisht përcakton se “*Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim*”.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit bazuar në nenin 194 të LPK-ës, nuk i ka shqyrtuar pikat II, III dhe IV të dispozitivit të Aktgjykimit të atakuar, që ka të bëjë me kamatën e gjykuar, pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit ndaj të paditurës, për shkak të komensimit të dëmit jo material dhe aprovimin e kërkesës për shpenzimet e procedurës, për arsye se asnjëra palë ndërgjyqëse këto pjesë të Aktgjykimit nuk i ka atakuar me ankesë.

Numri i lëndës: 2019:227173
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05624086

Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat e), të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2818/2021, datë 24.04.2024

Kryetari i Kolegjit,
Ardian Ajvazi